



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:259009

Datë: 12.04.2024

Numri i dokumentit: 05566541

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci , në çështjen penale kundër të akuzuarit P.K., nga fshati J... Komuna Gjakovë , për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së ,sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë PP/II.nr.578/2023 të datës 28.12.2023, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **08.04.2024** , në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra, mbrojtësit të akuzuarit av. Visar Perlaska sipas detyrës zyrtare dhe të akuzuarit P.K., me datën 12.04.2024 , mori dhe shpalli .këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **P.K.**, nga fsh... K. Gjakovë, i lindur me dt...në Gjakovë, nga i ati ..e ëma .. e vajzërisë .. kryer shkollën e mesme, bujk , i gjendjes së dobët mesme ekonomike , i martuar , atë i 1 fëmijë ,shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, , me numër personal ..6,me nr.tel:...

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

I.- Me datë 27.12.2022, rreth orës 11:00 minuta në fshatin ... K. Gjakovë, i pandehuri përdor armën në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në atë mënyrë që i njëjti ditën kritike pas përfundimit të ahengu familjar në shtëpinë e tij, në shenjë gëzimi shtënë dy herë në drejtim të tokës me armën e zjarrit Sig Sauer P225 me nr. serik M410924.

-me çka ka kryer veprën penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së.

II.- Nga data 06.11.2019 e deri me dt.27.12.2022 rreth orës 11:00, në fshatin ...K. Gjakovë, i pandehuri mbanë në pronësi, kontroll ose posedon armë në kundërshtimin e ligjit për armët Nr. 05/L/022, në atë mënyrë që ditën kritike kryen veprimet si në pikën nën I të dispozitivit, për të cilin fakt zyrtarët policor marrin informatë të cilët edhe shkojnë në vendin e ngjarjes me ç ‘rast kontaktojnë të pandehurin i cili edhe ju dorëzon vullnetarisht armën e zjarrit - pistoletën Sig Sauer P225 me nr. serik M410924, të cilën e posedonte në kundërshtim me ligjin mbi armët, e cila armë nga zyrtarëve policor sekuestrohet.

- me çka ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,7,17, 38 ,39,40,43,47,48 49,69,70 nenit 367 par.1 të KPRK-së dhe nenit 366 par.1 të KPRK-së ,dhe nenit 364 të KPPK-së të akuzuarit P.K.,

- Për veprën penale të përshkruar në pikën I-rë të dispozitivit ,Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së , dënim me burgim në kohëzgjatje prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh** ,

- Për veprën penale të përshkruar në pikën II-të të dispozitivit , Mbajtja në pronësi ,kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1, të KPRK-së , dënim me gjobë **në shumën prej 500.-(pesëqind) €**, të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit .

Me kërkesën dhe pëlqimin e mbrojtësit të akuzuarit av.Visar Perlaska dhe pëlqimin e të akuzuarit, konform nenit 44 të KPRK-së , dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditësh. I ZËVËNDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej 1100.-(njëmijë e njëqind)) euro.**

Bazuar në nenin 76 par.1 dhe 2 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Dënimin unik me gjobë në shumë **prej 1600.-(njëmijë e gjashtëqind) euro**, të cilin dënim , **i akuzuari është e obliguar ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjet) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.**

Nëse i akuzuari P.K. z , nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën e zëvendësuar të dënimit unik në shumë prej **1600.-(njëmijë e gjashqind) euro** sipas nenit 43 par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **80 (tetëdhjetë) ditësh** , duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)euro**

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej **20.00 €** si dhe ë emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30.00 €**, e këtë në afat prej **15 ditësh**, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-ës, të akuzuarit i :

Konfiskohet **arma – pistoleta e tipit Sig Sauer P225 e kalibrit 9x19mm me nr. serik M410924 dhe dy gëzhoja të kalibrit 9mm, i sekuestruar me datën 27.12.2022, si mjet i kryerjes së veprave penale.**

A r s y e t i m

1.Ecurija e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.578/23 të datës 28.12.2023, ka akuzuar të akuzuarin P.K., nga fshati ... Komuna Gjakovë ,për shkak të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367. par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së ,duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale si dhe konform nenit 366 par.3 të KPRK-së të konfiskohet arma e përshkruar.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 08.04.2024 , përfaqësuesi i PTH-DP në Gjakovë Prokurori i shtetit Qazim Xharra ,lexoi aktakuzën PP/II.nr.578/23 të datës 28.12.2023, me ç ‘rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës .

I akuzuari P.K , gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi se pas konsultimit te mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Visar Perlaska, sipas detyrës zyrtare, theksoi se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë dhe i njëjti lidhur me fajësinë deklaroi: ndihem fajtor për veprat penale me te cilat pandehem, premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshëm, të njëjtën e kam përdor me rastin e një ahengu familjar, duke mos ditur se një gjë e tillë është e ndaluar , dhe atë pasi janë larguar te gjithë të ftuarit e ahengut, andaj i propozon gjykatës që të merr parasysh rrethana lehtësuese pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës , premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, pendimin e shprehur në gjykatë, faktin se me parë nuk kam ra ndesh me ligjin ,të më shqiptoi një dënim më të butë.

Mbrojtësi i te akuzuarit av. Visar Perlaska , deklaroi se me qe i mbrojturi im në mënyrë vullnetare dhe pa presion ka pranuar fajësinë për veprat penale e cila i vihet ne barrë , propozoi kësaj gjykate që te njëjtit pranim të fajësisë të aprovojë . Lidhur me vendimin për dënimin gjykatës i propozoi që ti shqiptojë dënimin më të butë, duke marr rrethanat lehtësuese e posaçërisht ato lehtësuese, qe për veprën penale përdorim i armës në përputhje me këto dispozita ti shqiptojë një dënim të kushtëzuar , si dhe për veprën penale armëmbajtje të i shqiptoje një dënim sa me të ultë dhe të jetë i ndarë në dy këste ,pasi që i njëjti siguron gjykatën se mund të e paguaj dhe të i përmbahet dënimit ashtu siç i propozuam. Ndërsa përmes parashtresës së datës 08.04.2024, e plotësojmë fjalën përfundimtare me rastin e propozimit të shqiptimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, që Gjykata të ketë parasysh një mori rrethanash lehtësuese dhe për veprën penale Përdorim i armës nga neni 367/1 të KPRK-së të aplikojë dispozitat për zbutje të jashtëzakonshme, të ketë një dënim deri në 6 muaj dhe i njëjti në kuptim të nenit 44 të KPRK-së ti bëhet zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë. Po ashtu edhe për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366/1 të KPPK-ës, propozojmë të i shqiptojë një dënim sa më të ulët me gjobë. Gjykatës i propozojmë nëse eventualisht të ketë parasysh këto rrethana si më lartë për këto dy vepra penale të i shqiptohet në mënyrë komulative një dënim unik me gjobë dhe të jetë i ndarë këste.

Prokurori i shtetit Qazim Xharra, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë të bërë në mënyrë vullnetare dhe pa preson, duke i ditur pasojat dhe benifitet e një pranimi te tillë i cili është bërë pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e te akuzuarit, po ashtu faktin se pranimi i fajësisë gjen mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike si ne dispozitiv të aktakuzës ku dhe përmbushen elementet e veprave penale për te cilat akuzohet. Lidhur me vendimin për dënimin i propozoi gjykatës që të pandehurin të shpallë fajtor , duke pasur parasysh përgjegjësin dhe rrezikshmërinë e veprës penale si dhe qëllimin e dënimit , ti vlerësojë të gjitha rrethanat si ato lehtësuese pranimin e fajësisë , dhe ato renduese shkallen e lartë te dashjes me kryerjen e veprës penale , gjykatës i propozoi që sipas nenit 366/3 të i konfiskohet arma e cila është objekt i veprës penale .

2.Vlersimi pranimi të fajësisë

Gjyqtarja e vetme gjykuese në shqyrtim gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilën ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari P.K., , për shkak të veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së , ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë së bërë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 241 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjykata konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij av. Visar Perlaska , pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata nga të cekurat me lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si ne dispozitivat e këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykon në bazë të ligjit ,me parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij .

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 366 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve e kryen *1. Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet. Ndërsa në par.3 të po këtij neni parashihet se “ . Arma në pronësi, kontroll apo posedim në kundërshtim të këtij neni konfiskohet.”*

Ndërsa në nenin 367 par.1 të KPRK-së , është parashikuar se veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm e kryen *“Kushdo që përdorë armë apo materie plasëse në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materiet plasëse të tilla, dënohet me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet. 2. Kushdo që përdor armën apo mjetin e rrezikshëm në mënyrë kërcënuese ose frikësuese, dënohet me gjobë deri në dhjetë mijë (10.000) Euro dhe me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet.”* Ndërsa në par. 3të po këtij neni parashihet se : *“ Arma apo mjeti i rrezikshëm i përdorur në kundërshtim të këtij neni konfiskohet ”.*

5. Vendimet e gjykatës

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur me lartë, gjykata të akuzuarin P.K., , e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilën ngarkohet sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll dhe posedim i paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së , prandaj për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Vendimi për konfiskimin e sendit : pistoleta e tipit Sig Sauer P225 e kalibrit 9x19mm me nr. serik M410924 dhe dy gëzhoja të kalibrit 9mm, i sekuestruar me datën 27.12.2022, si mjet i kryerjes së veprës penale. është marr bazuar në nenin 366 par.3 të KPRK-së.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoj të gjitha rrethanat konform nenit 69,70 dhe 71 paragraf 1 nën paragraf 1.1 dhe 1.3 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Si rrethanë rënduese për të akuzuarin konstaton faktin se i akuzuari ka kryer veprat penale të përshkruar në dispozitivat e këtij aktgjykimi, peshën e veprës penale dhe rrezikshmërinë e këtyre veprave si dhe faktin se nga Evidenca penale PDP për të akuzuarin: i njëjti evidentohet me lëndën penale **P.nr.217/23** - neni 185/1 - Dënim me gjobë 250 euro - i PF.20.09.2023 - në Gj.Prizren., ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është i moshës relativisht të re, bujk, mbajtës i vetëm i familjes prej 5 anëtarësh, sjelljen e tij tejet korrekte në gjykim, i gjendjes së dobët ekonomike, Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personalitetin e tij që te gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm, korrekt, i urtë, i vetëdijshëm për pasojat. Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës, shprehjen e keq ardhjes për rastin që i ka ndodhur, premtimi se një veprim i tillë nuk do të përsëritet. Kështu që duke mos gjetur rrethana veçanërisht rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret eksitojnë kushtet për zbutjen e dënimit dhe në rastin konkret ka aplikuar dispozitën e nenit 72 par.1 nën.par.1.5 të KPRK-së, kur ka shqiptuar dënimin me burgim nën minimumin e paraparë ligjor për veprën në dispozitivin e I-rë dhe atë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 150 ditësh si dhe dënimin me gjobë prej 500.00 për veprën penale nga dispozitivi i II-të i aktakuzës.

Gjykata, me kërkesën e mbrojtësit të akuzuarit av. Visar Perlaskaj dhe pëlqimin e të akuzuarit P.K., Gjykata në kuptim të dispozitës të nenit 44 të KPRK-së, dënimin e shqiptuar me burgim për veprën penale të përshkruar në dispozitivin e I-rë, e ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 1100.- (njëmijë e njëqind) euro.

Gjykata sipas bindjes së saj, vlerësoj se shqiptimi i dënimit unik si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i tij, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston me parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprës penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 452 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 paragrafi 3, nën. par. 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 452 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 39 paragrafi 3, nën. par. 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-Divizioni Penal
2023:259009 datë 12.04.2024

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **30 ditësh**, nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.